

AWR

ABBRUCH

GMBH

www.awr-abbruch.de

QELAJ: PROCESI NË HAGË PO ZHVILLOHET PA TRANSPARENCË DHE PA GARANCI PËR DREJTËSI

FAQE 4-5

Zgjatjen e paraburgimit për të akuzuarit në Dhomat e Specializuara në Hagë, Avokati i Popullit, Naim Qelaj, e ka cilësuar si të papranueshme dhe në kundërshtim me standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke theksuar se procesi gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së po zhvillohet me mungesë transparence dhe në rrethana që ngrenë dilema serioze për drejtësinë

AKTUALE



KINA I PËRGJIGJET NDALESËS SË BE-së ME KUFIZIME NDAJ IMPORTIT TË PAJISJEVE MJEKËSORE EVROPIANE

F. 2

SULMET AJRORE IZRAELITE VRASIN 33 PALESTINEZË NË GAZË

F. 2

VALA E TË NXEHTIT AFRIKAN LARGOHET NGA KOSOVA, NGA E MËRKURA RESHJE DHE ULJE E TEMPERATURAVE

F. 6



EKONOMI



KOSOVA RRIËT 100 PËR QIND IMPORTIN NGA SERBIA

F. 7

ZRRE MBRON VENDIMIN PËR TREGUN E LIRË ENERGJETIK, BIZNESET E KUNDËRSHTOJNË

F. 7

MIJËRA QYTETARË TË KOSOVËS JETOJNË NË BANESA PA PRANIM TEKNIK

F. 3



"AINVEST": NGËRÇI POLITIK I KOSOVËS, NJË UDHËKRYQ QË KËRCËNON INVESTIMET RAJONALE. DURIMI I BE-SË PO PAKËSOHET

F. 2



RENOVA

PUTZ

Maqedoni

Xhepcisht -Tetovë

Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009

+389 44 487 755

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.PK.

NDËRTIM

PROJEKTIM

SHITJE

INFO: 049-111-101,

044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051

044/367-061

028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com

info@kolegjbiznesi.com

030 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A

DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,

Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,

E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri

+38344685122

Internet Website,

Marketing...

Kina i përgjigjet ndalesës së BE-së me kufizime ndaj importit të pajisjeve mjekësore evropiane

PEKIN, 6 KORRIK - Ministria e Financave e Kinës njoftoi të dielën se do t'i kufizojë blerjet qeveritare të pajisjeve mjekësore nga Bashkimi Evropian që kalojnë vlerën mbi 45 milionë juanë, apo 6.3 milionë dollarë, si kundërpërgjigje ndaj masave kufizuese të Brukselit. Marrëdhëniet midis Pekinit dhe Brukselit janë trazuar, pasi Bashkimi Evropian vendosi tarifa mbi automjetet elektrike të ndërtuara në Kinë dhe Kina vendosi taksa mbi importet e alkoolit nga BE-ja. Muajin e kaluar, Bashkimi Evropian njoftoi se do t'ua ndalonte kompanive kineze pjesëmarrjen në tenderë publikë të BE-së për pajisje mjekësore me vlerë 60 miliardë

euro, ose më shumë në vit, pasi arriti në përfundimin se kompanitë evropiane nuk kishin qasje të barabartë në tregun kinez. Kjo masë u ndërmor nga Komisioni Evropian në përputhje me Mekanizmin Ndërkombëtar të Prokurimeve të BE-së, që hyri në fuqi në vitin 2022 dhe synon të sigurojë qasje të ndërsjellë në tregje. Kundërmasat e Kinës ishin të pritshme pasi Ministria e Tregtisë sinjalizoi “masa të nevojshme” kundër vendimit të BE-së në fund të muajit të kaluar. “Për fat të keq, pavarësisht vullnetit të mirë dhe sinqeritetit të Kinës, BE-ja ka këmbëngulur të ndjekë rrugën e vet, duke ndërmarrë masa kufizuese dhe duke



ngritur barriera të reja proteksioniste”, tha Ministria e Tregtisë në një deklaratë të dielën. “Prandaj, Kina nuk ka zgjidhje tjetër përveçse të marrë masa të ndërsjella kufizuese”, shtoi ajo.

Ministria e Financave tha gjithashtu se Kina do t'i kufizojë importet e pajisjeve mjekësore nga vende të tjera që përmbajnë komponentë të prodhuar në BE në më shumë se 50 për qind të vlerës së

kontratës. Masat hyjnë në fuqi qysh sot. Ministria e Tregtisë sqaroi se produktet e kompanive evropiane që operojnë brenda Kinës nuk do të preken. Javën e kaluar, Kina gjithashtu njoftoi vendosjen e tarifave deri në 34.9 për qind për pesë vjet mbi alkoolin e importuar nga Bashkimi Evropian - pjesa më e madhe prej tij konjak nga Franca - pas përfundimit të një hetimi që besohet të jetë kundërpërgjigje ndaj tarifave të BE-së për makinat elektrike. Megjithatë, prodhuesit kryesorë të konjakut si Pernod Ricard, LVMH dhe Remy Cointreau u përjashtuan nga tarifat, me kusht që të shesin me një çmim minimal, të cilin Kina nuk e ka bërë publik.

Qindra mijëra afganë detyrohen të largohen nga Irani, thotë OKB-ja

Qindra mijëra afganë janë larguar nga Irani javët e fundit, pasi Teherani u dha afat deri më 6 korrik më shumë se katër milionë imigrantëve afganë pa dokumente për ta lënë vendin, thanë Kombet e Bashkuara dhe organizata të tjera ndërkombëtare, duke ngritur alarmin për mungesën e theksuar të fondeve për t'i ndihmuar të kthyerit. Më shumë se 256.000 afganë janë kthyer në vendin e tyre nga Irani vetëm gjatë qershorit, sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). Agjencia tha se rritja e madhe e numrit të të riatdhësuarve po e bën të vështirë për IOM-in dhe partnerët për të ofruar ndihmë. Këto organizata arrijnë t'i ndihmojnë vetëm te 10 për qind të atyre që kanë nevojë. Irani thotë se i strehon më shumë se 6 milionë afganë, shumë prej të cilëve jetojnë atje pa status të ligjshëm. Shumë imigrantë afganë pretendojnë se përballen me diskriminim të rregullt në Iran. Disa media iraniane kanë raportuar se edhe afganët me



viza të vlefshme janë dëbuar me forcë gjatë valës së fundit të dëbimeve. Lufta 12-ditëshe e Iranit me Izraelin në mes të qershorit thuhet se ka kontribuar në largimet, me mediat shtetërore iraniane dhe përdorues të rrjeteve sociale që pretendojnë se një numër i pacaktuar shtetasish afganë janë arrestuar nën dyshime për spiunazh për Izraelin. Afganët ndalohen nën akuza për spiunazh

Richard Bennett, raportuesi i posaçëm i OKB-së për të drejtat e njeriut në Afganistan, tha në platformën X më 5 korrik se “qindra” afganë dhe pjesëtarë të pakicave të tjera etnike dhe fetare janë ndaluar dhe “akuzuar për spiunazh”. Bennett gjithashtu shprehu shqetësim për atë që e përshkroi si “etiketimin e afganëve [dhe] komuniteteve pakicë si tradhtarë” nga mediat iraniane. Disa imigrantë që jetojnë në

Iran i thanë Radios Evropa e Lirë se afganët e arrestuar për akuza spiunazhi janë keqtrajtuar në paraburgim dhe më pas janë dëbuar në Afganistan, pavarësisht se kishin leje qëndrimi dhe dokumentacion të vlefshëm. Një i ri afgan që jeton në Teheran i tha REL-it se babai i tij u arrestua dhe u keqtrajtua nga policia iraniane për një akuzë të rrejshme për spiunazh. “Babai im u arrestua dhe u torturua për akuza spiunazhi”, tha ai në kushte anonimiteti. I riu shtoi se viza e tij ka skaduar së fundmi dhe ai nuk del më jashtë nga frika se do të arrestohet dhe dëbohet. Një tjetër refugjat afgan ndau rrëfim të ngjashëm, duke thënë se “situata e refugjatëve afganë është përkeqësuar më tej gjatë një apo dy javëve të fundit”. “Edhe ata që kanë status të ligjshëm dhe punë jetojnë në frikë. Shumë prej miqve tanë janë dëbuar. Situata është shumë shqetësuese”, i tha ai REL-it më 6 korrik. IOM-i dhe organizata të tjera ndërkombëtare, si Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq

dhe Gjysmëhënës së Kuqe (IFRC), që ofrojnë ndihmë për të kthyerit, thanë se shumë afganë mbërrijnë “vetëm me rrobat që kanë veshur” dhe “në nevojë urgjente për ushqim, kujdes mjekësor dhe mbështetje”. IFRC-ja tha më 5 korrik se grupe të mëdha afganësh, përfshirë shumë fëmijë, po mbërrijnë nëpërmjet pikës kufitare Islam Qala, pasi kanë përjetuar “lodhje, uri dhe pasiguri gjatë rrugës së kthimit”, me temperatura mbi 43 gradë celsius. Sipas IFRC-së, më shumë se 800.000 afganë janë kthyer nga Irani që nga janari. Ndërkohë, qindra mijëra të tjerë janë kthyer nga Pakistani, një tjetër vend pritës për refugjatët afganë. Pakistani planifikon t'i dëbojë 3 milionë afganë këtë vit. Agjencia për refugjatë e OKB-së, UNHCR, tha muajin e kaluar se të paktën 1.2 milion afganë janë detyruar të kthehen nga Irani dhe Pakistani deri tani këtë vit, duke shkaktuar një krizë që mund të destabilizojë më tej situatën e brishtë në Afganistan.

Sulmet ajrore izraelite vrasin 33 palestinezë në Gazë

GAZA, 6 KORRIK - Sulmet ajrore izraelite i kanë vrarë të paktën 33 palestinezë në Gazë, thanë zyrtarët shëndetësorë të dielën, ndërsa ushtria izraelite njoftoi se ka goditur mbi 100 objektiva në enklavën e rrënuar nga lufta. Sulmet ndodhën ndërsa

kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, po përgatitej të udhëtonte drejt Uashingtonit për bisedime në Shtëpinë e Bardhë, me qëllim shtyrjen përpara të përpjekjeve për një armëpushim. Ndërkohë, një zyrtar izraelit

tha se kabineti i sigurisë i Izraelit miratoi të shtunën mbrëma dërgimin e ndihmave në pjesën veriore të Gazës, ku civilët po vuajnë nga mungesa e theksuar e ushqimit. Zyrtari nuk dha më shumë hollësi dhe foli në kushte anonimiteti.



MIJËRA QYTETARË TË KOSOVËS JETOJNË NË BANESA PA PRANIM TEKNIK



PRISHTINË, 6 KORRIK - Në kryeqytetin e Kosovës, dhjetëra mijëra banesa janë të banuara, por pa dokumentin më të rëndësishëm ligjor: certifikatën e përdorimit. Kjo mungesë, që prek mbi 85 për qind të ndërtimeve të larta, i lë banorët në pasiguri juridike

Prishtinë, 6 korrik- Që pesë vjet, Besim Shala dhe familja e tij 4-anëtarëshe jetojnë në një banesë në katin e pestë të një ndërtese në lagjen Rruga B në Prishtinë, por, as sot e kësaj dite, ai nuk është pronar ligjor i saj. Shala e ka blerë banesën në fillim të vitit 2020 për rreth 80 mijë euro dhe ka nënshkruar kontratën me investitorin te noteri.

Përkundër kësaj, emri i tij nuk figuron ende në dokumentacionin zyrtar të pronësisë në komunë. “Kam kërkuar disa herë nga pronari që banesa të kalojë në emrin tim, por, secilën herë, përgjigja ka qenë se është në procedurë të marrjes së certifikatës së përdorimit në komunë”, thotë Shala për “Radion Evropë e Lirë”.

Arsyeja? Investitori nuk e ka marrë ende certifikatën e përdorimit për ndërtesën, e njohur ndryshe si pranimi teknik.

Ky është një dokument thelbësor që vërteton se objekti është ndërtuar në përputhje me lejen ndërtimore dhe se i plotëson kushtet për banim të sigurt - duke përfshirë funksionimin e rregullt të instalimeve elektrike, ujësjellësit, ngrohjes dhe ventilimit.

Rasti i Shalës nuk është i izoluar. Në Prishtinë, rreth 85 për qind e ndërtesave të larta nuk e kanë certifikatën e përdorimit.

Sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, gjatë viteve 2017-2021 janë dhënë vetëm 46 certifikata

përdorimi për mbi 300 ndërtime të larta. “Vetëm 15 për qind e lejeve të lëshuara për ndërtim gjatë kësaj periudhe janë pajisur me certifikatë të përdorimit”, thuhet në raportin “Efikasiteti dhe efektiviteti në procesin e ndërtimeve të larta në Komunën e Prishtinës”, i cili është publikuar në muajin mars nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Raporti thekson se pa certifikatën e përdorimit, ndërtesat nuk konsiderohen të sigurta për banorët, nuk i plotësojnë standardet ligjore për jetesë dhe nuk u japin qytetarëve të drejtën e plotë ligjore mbi pronën.

Për lejet e ndërtimit të lëshuara në vitet 2022-2023, raporti shpjegon se ato nuk janë përfshirë në analizë, pasi ndërtimet nuk kanë përfunduar ende dhe nuk mund të vlerësohen.

Ndërkohë, në periudhën 2014-2023, Komuna e Prishtinës ka lëshuar gjithsej 1.601 leje ndërtimore, por vetëm 147 prej tyre kanë përfunduar me certifikatë të përdorimit.

“Radio Evropa e Lirë” ka kërkuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) të dhëna për situatën e certifikatave të përdorimit të banesave në të gjitha komunat e Kosovës.

Në përgjigje, ministria ka thënë se nuk posedon statistika specifike, pasi ndërtimet e kësaj kategorie janë kompetencë ekskluzive e vetë komunave.

Por, në një paraqitje para Kuvendit të Kosovës në fund të vitit 2022, ministri Liburn Aliu ka thënë se mbi 75 për qind e ndërtesave në të gjithë vendin janë ndërtuar pa leje ndërtimi dhe, rrjedhimisht, pa certifikata të përdorimit. “Në gjithë Kosovën, mbi 352.000 objekte janë pa leje, ndërsa vetëm

në Prishtinë ka rreth 46.000 ndërtesa të tilla”, ka thënë atëkohë Aliu.

“Radio Evropa e Lirë” ka kërkuar të dhëna edhe prej disa komunave më të mëdha të Kosovës - Gjakova, Ferizaj, Peja, Mitrovica e Jugut, Gjilani dhe Prizreni - për numrin e lejeve ndërtimore dhe certifikatave të përdorimit të lëshuara gjatë periudhës 2017-2021, por asnjëra nga to nuk ka kthyer përgjigje.

Driton Tafallari, ish-këshilltar në Ministrinë e Mjedisit, thotë se mungesa e certifikatave të përdorimit është problem i përhapur në pothuajse të gjitha komunat e Kosovës.

Ai thotë se situata është edhe më shqetësuese në komunat e mëdha, ku ndërtimet janë më të shumta dhe më intensive.

Sipas tij, mbi 90 për qind e banesave në nivel vendi nuk kanë pranim teknik.

Problemi, thotë Tafallari, buron kryesisht nga papërgjegjësia e investitorëve që nuk aplikojnë për certifikatë përdorimi, por edhe nga mungesa e kontrollit institucional gjatë procesit të ndërtimit.

Ai shton se shumë ndërtues nuk u janë përmbytur projekteve për të cilat kanë marrë leje ndërtimi, duke bërë zgjerime ose ndryshime që i pengojnë të aplikojnë për pranimin teknik të objektit. “Ata i kanë rritur sipërfaqet e ndërtimit, kanë shtuar kate mbi sa janë pranuar me leje ndërtimore. Ndaj, kur ka mospërputhje mes lejes së ndërtimit dhe gjendjes reale në terren, organi përgjegjës nuk ka të drejtë ta lëshojë certifikatën e përdorimit”, thotë Tafallari për “Radion Evropë e Lirë”.

Edhe Ilir Gjinolli, profesor i Urbanizmit dhe Planifikimit

Hapësinor në Universitetin e Prishtinës, vlerëson se një pjesë e fajit qëndron te ndërtuesit, por përgjegjësia më e madhe, sipas tij, bie mbi autoritetet komunale, të cilat nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të kryer inspektime gjatë fazës së ndërtimit.

Faton Hoxha, kryetar i Shoqatës së Ndërtimtarëve të Kosovës, pranon se një numër i madh ndërtesash në vend janë të banuara pa certifikatë të përdorimit.

Por, ai thotë se ka raste kur investitorët kanë kërkuar të pajisen me këtë dokument, e komunat nuk e kanë lëshuar në kohë.

Pasojat për qytetarët

Mungesa e certifikatës së përdorimit sjell pasoja serioze për blerësit e banesave, thotë Tafallari. Përveç mungesës së sigurisë juridike për banim, qytetarët nuk mund t'i përdorin këto prona si hipotekë për kredi, as nuk mund t'i shesin ligjërisht, sipas tij. “Përveç kësaj është edhe ngarkesa psikologjike, sepse gjatë gjithë kohës e ke ndjenjën se po jeton në një banesë që ka telashe juridike”, thotë Tafallari.

Sipas vlerësimit të Gjinollit, nuk janë vetëm banorët që humbin nga kjo situatë, por edhe vetë komunat. “Aty ku nuk ka një certifikatë përdorimi, nuk ka mundësi të regjistrohet prona në kadastër. Kështu, në humbje janë të gjithë, përfshirë ata që e kanë blerë një banesë apo pronë tjetër dhe komunën, e cila humb taksat në pronë”, thotë Gjinolli për “Radion Evropë e Lirë”.

Shala, i cili jeton në një banesë pa dokumentacion të rregullt pronësor, tregon se ka tentuar të

marrë kredi në një bankë komerciale, por se nuk ka mundur ta përdorë banesën si garanci. “Unë jam jashtëzakonisht i shqetësuar, sepse është bërë shumë. Derisa nuk kam dëshmi se kjo është prona ime, unë nuk ndjem rehat”, thotë ai.

Cila është zgjidhja?

Për të gjetur një zgjidhje për këtë situatë, profesori Gjinolli thotë se duhet vullnet nga të gjithë aktorët, veçanërisht nga ata që përfitojnë drejtpërdrejt.

Sipas tij, banorët duhet t'u bëjnë trysni autoriteteve komunale për të zbatuar ligjin dhe për të lëshuar certifikatat e përdorimit, ndërsa qeveria duhet t'i ndihmojë komunat me burime financiare, kapacitete njerëzore dhe teknike. “Duhet të ketë një afat të caktuar, që do të përfshinte inspektimin dhe certifikimin e të gjitha ndërtesave, duke mos pritur aplikimin nga ndërtuesit, por duke shkuar direkt tek ata”, thotë Gjinolli.

Ligji për Ndërtim parashikon dënime për përdorimin e objekteve pa certifikatë të përdorimit.

Investitorët mund të gjobiten nga 1.000 deri në 30.000 euro nëse objekti është në funksion pa këtë dokument ligjor.

“Radio Evropa e Lirë” pyeti disa prej komunave më të mëdha në Kosovë - Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Gjilan etj. - se sa e monitorojnë zbatimin e Ligjit për Ndërtim dhe sa është numri i kompanive ndërtuese të gjobitura për përdorim të objekteve të larta pa certifikatë përdorimi, por, deri në publikimin e këtij artikulli, nuk mori përgjigje prej asnjërës.



'AINVEST': NGËRÇI POLITIK I KOSOVËS, NJË UDHËKRYQ QË KËRCËNON INVESTIMET RAJONALE. DURIMI I BE-SË PO PAKËSOHET

PRISHTINË, 6 KORRIK - Paraliza politike e Kosovës që nga shkurti 2025 është kthyer në një pikë ndezeje për paqëndrueshmërinë rajonale, duke hedhur hije mbi mundësitë e investimeve në Ballkanin Perëndimor. Me 21 (tash 42) përpjekje të dështuara për ta zgjedhur kryetarin e parlamentit dhe pa ndonjë koalicion në horizont, bllokada institucionale ka penguar përparimin drejt integritimit në BE, ka ngrirë financime jetike dhe ka shtuar tensionet me Serbinë. Për investitorët, ky skenar thekson rrezikun e lartë të pasigurisë gjeopolitike në një rajon ku kompromisi politik është i pakapshëm, shkruan platforma "Ainvest", e cila ofron analiza financiare të avancuara përmes inteligjencës artificiale.

Bllokada institucionale: Një pengesë për reformat

Partia Lëvizja Vetëvendosje (VV) e kryeministrit Albin Kurti mban 48 ulëse në parlamentin prej 120 anëtarësh - larg nga 61 të nevojshmet për shumicë. Partitë opozitare, përfshirë Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kanë refuzuar kandidaturën e Kurtit për

kryetar parlamenti, Albulena Haxhiun, duke e akuzuar atë si figurë përçarëse. Refuzimi për ta formuar një koalicion apo qeveri kalimtare e ka lënë Kosovën në status kujdestarie, duke bllokuar reformat e kërkuara për anëtarësim në BE dhe duke ngrirë 6 miliardë euro nga fondet e Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor. Durimi i BE-së po pakësohet. Brukseli e ka lidhur lirin e këtyre fondeve me formimin e një qeverie funksionale, ndërkohë që mban në fuqi masat ndëshkuese të vendosura në vitin 2023 për shkak të tensioneve në veri të Kosovës. Këto sanksione, përfshirë pezullimin e kontakteve diplomatike dhe ndihmave për zhvillim, i kanë kushtuar ekonomisë së Kosovës rreth 3 milionë euro në ditë. Për investitorët, kjo përkthehet në projekte infrastrukturore të vonuara, privatizime të pezulluara dhe një afat të pasigurt për reformat rregullatore që janë kritike për operacionet e biznesit.

Rreziqet gjeopolitike po rriten

Kriza politike e Kosovës është e ndërlidhur me statusin e saj të pazgjidhur në sytë e Serbisë

dhe pesë shteteve anëtare të BE-së. Statuti i projektuar i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe (AKS), të cilin Kosova ka refuzuar ta paraqesë në Gjykatën e saj Kushtetuese, mbetet një pengesë për BE-në. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić ka kritikuar politikën e ashpra të Kurtit në veri të Kosovës, përfshirë ndalimin e dinarit serb dhe rritjen e pranisë policore. Këto veprime rrezikojnë t'i rindezin tensionet etnike, ta dekurajojnë tregtinë ndërkufitare dhe t'i destabilizojnë korridoret energjetike si gazsjellësi Greqi-Ballkan-Itali. Ndërkohë, roli i ShBA-ve është i turbullt për shkak të pasigurisë. Një ndryshim i mundshëm në politikën amerikane nën një administratë Trump mund të sjellë ulje të mbështetjes për misionin e NATO-s KFOR, i cili prej kohësh ka qenë një forcë stabilizuese. Përpjekja e Kosovës për të lidhur marrëveshje bilaterale sigurie me Mbretërinë e Bashkuar dhe shtete të tjera të BE-së nxjerr në pah ndjeshmërinë e saj ndaj lëkundjeve gjeopolitike. Për investitorët, kjo paqëndrueshmëri krijon rreziqe në sektorë si energjia

dhe transporti, ku pasiguria gjeopolitike mund të ndërpresë zinxhirët e furnizimit dhe projektet infrastrukturore.

Kosto ekonomike dhe implikimet për investime

Ngërçi tashmë ka lënë gjurmë në ekonominë e Kosovës. Me papunësinë në 30%, mungesa e veprimeve të qeverisë ka shtypur investimet publike dhe rritjen e sektorit privat. Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) vlerëson se rritja e PBB-së së Kosovës mund të bjerë nën 2% këtë vit - në kontrast të thellë me projeksionet para krizës prej 3.5%. Investitorët duhet të veprojnë me kujdes në rajon: Shmangni Ekspozimin e Drejtpërdrejtë: Derisa të formohet një qeveri, sektorët që varen nga financimi publik - si ndërtimi ose shërbimet komunale - janë me rrezik të lartë, shkruan kjo platformë. Kërkoni mundësi të tërthorta: Merrni parasysh sektorët më pak të varur nga stabiliteti politik, si teknologjia informative ose shërbimet e mbështetura nga remitancat. Monitoroni diplomacinë e BE-

së: Një përparim në dialogun Kosovë-Serbi ose heqja e sanksioneve të BE-së mund ta çlirojë një valë investimesh në infrastrukturë dhe energji. Siguroni veten kundër rreziqeve gjeopolitike: Përdorni instrumente derivativë ose sigurime të tregjeve rajonale për të zbutur ekspozimin ndaj tregjeve të Ballkanit.

Përfundim: Një udhëkryq për stabilitetin

Kriza politike e Kosovës nuk është thjesht një mosmarrëveshje e brendshme - është një provë për aftësinë e Ballkanit Perëndimor për t'u bashkuar përballë ndarjeve gjeopolitike. Ndërsa emërimi i një të dërguari të ri të posaçëm të BE-së sjell shpresë, rruga drejt kompromisit mbetet e vështirë. Për investitorët, durimi dhe diversifikimi janë kyçe. Rreziku është i madh: një paqëndrueshmëri e zgjatur mund t'i rrëzojë aspiratat sovraane të Kosovës dhe integritimin rajonal, ndërsa një përparim mund ta hapë rrugën për një dekadë rritjeje. Muajt e ardhshëm do të përcaktojnë nëse ky udhëkryq do të çojë në përparim - apo në një rënie të mëtejshme.

QELAJ: PROCESI NË HAGË PO ZHVILLOHET PA TRANSPARENCË DHE PA GARANCI PËR DREJTËSI

PRISHTINË, 6 KORRIK - Zgjatjen e paraburgimit për të akuzuarit në Dhomat e Specializuara në Hagë, Avokati i Popullit, Naim Qelaj, e ka cilësuar si të papranueshme dhe në kundërshtim me standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke theksuar se procesi gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së po zhvillohet me mungesë transparence dhe në rrethana që ngrenë dilema serioze për drejtësinë.

Në një intervistë për “Ekonomia Online”, Qelaj ka theksuar se institucionet vendore do të duhej të luanin rol më aktiv në monitorimin e procesit për të garantuar që po zbatohen standardet ndërkombëtare për një proces të drejtë dhe të barabartë. “Po bëhen pesë vite nga kur ka filluar funksionimi i kësaj gjykate. Unë konsideroj që ka shumë dilema lidhur me atë se a po respektohen standardet për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Ka munguar një transparencë e kësaj gjykate për t’i dhënë përgjigje pyetjeve, shqetësimeve dhe dilemave të opinionit publik. Natyrisht janë çështje të ndërlikuara, delikate, të ndjeshme, për të cilat unë konsideroj që edhe institucionet vendore është dashur që të bëjnë më shumë



në drejtim të monitorimit të këtij procesi gjyqësor, për t’u garantuar dhe për t’u siguruar që po garantohen dhe po respektohen këto standarde”, tha ai.

Një nga shqetësimet kryesore

të Avokatit të Popullit është zgjatja e paraburgimit të të akuzuarve, që sipas tij bie ndesh me të drejtën për mbrojtje në liri dhe me vetë parimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Qelaj ka shtuar se një qasje e tillë krijon edhe një pasojë të dytë dëmton besimin në institucionet vendore dhe aftësinë e tyre për të garantuar mbrojtje të pavarur. “Vetë fakti i zgjatjes së

paraburgimit për kaq periudhë të gjatë kohore konsideroj që është kundërshtim me standardet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, cenon të drejtën e personave të akuzuar që të mbrohen në liri. Në anën tjetër, vendos në vështirësi edhe vetë institucionet e Kosovës, nga se shprehet një lloj mosbesimi për të siguruar çfarëdo forme tjetër të mbrojtjes në liri nga këto institucione”, tha ai.

Avokati i Popullit ka bërë të ditur se ka shprehur interesimin për ta vizituar të paraburgosurit në Hagë, për të ndjekur nga afër disa seanca gjyqësore dhe për të zhvilluar takime me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse. “Nuk e di. Unë kam shpreh vullnetin tim për t’i vizituar të burgosurit në Hagë, për t’i monitoruar disa seanca, me aq sa më lejohet kohë dhe mundësi. E më pas edhe një takim me vetë përfaqësuesit e gjykatës, Avokatin e Popullit atje dhe me mbrojtësin e viktimave. Pra që ta kem një pasqyrë të qartë dhe të plotë se çfarë po ndodh. Pastaj së paku përmes qëndrimeve të mia publike për ta njoftuar opinionin lidhur me ato dilema dhe shqetësime që i kanë ngritur ndërkohë”, tha ai.

KËRCËNIMI ME BOMBË NË KUVEND ME NUMËR SERB, KURTI: LUFTË AKTIVE HIBRIDE NGA SERBIA

PRISHTINË, 6 KORRIK - Ministri i Brendshëm në detyrë i Kosovës, Xhelal Sveçla, ka thënë se kërcënimin me bombë ndaj Kuvendit të Republikës së Kosovës, institucionet relevante të sigurisë e kanë trajtuar me prioritet të lartë, i cili ka pasur origjinën në Serbi. “Numri i telefonit nga i cili është bërë kërcënimi është i regjistruar në Serbi dhe i përket kompanisë telefonike MTS. Shfrytëzuesi i numrit ka qenë ose është shtetasi serb Lazar Živković. Në disa profile të lidhura me këtë numër është gjetur fotografia e kriminelit të luftës Ratko Mladić. Institucionet e Kosovës janë duke trajtuar rastin me prioritet të lartë dhe do të kërkojnë mbështetje ndërkombëtare për arrestimin dhe vënien para përgjegjësisë të personave që qëndrojnë pas kërcënimit, sa më shpejt që të

jetë e mundur. Sulmuesit dhe kërcënuesit që strehohen në Serbi, pavarësisht mbështetjes nga shteti serb, nuk do të arrijnë t’i shmangen përgjegjësisë”, ka thënë Sveçla.

Ndërkaq kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka përgëzuar institucionet shtetërore për reagimin e shpejtë dhe profesional pas zbulimit të kërcënimit me bombë në Kuvendin e Kosovës. Në një postim në “Facebook”, Kurti u shpreh se konfirmimi se kërcënimi ka origjinën në Serbi, dëshmon përpjekjet për të zhvilluar “luftën aktive hibride” kundër Kosovës. “Përgëzoj institucionet shtetërore për reagimin e shpejtë dhe profesional. Konfirmimi se ky kërcënim e ka origjinën në Serbi dëshmon edhe një herë luftën aktive hibride të Serbisë ndaj vendit tonë”, ka shkruar Kurti.



NGRIHET AKTAKUZË KUNDËR MINISTRIT FIKRIM DAMKA, DYSHOHET PËR KEQPËRDORIM TË DETYRËS

PRISHTINË, 6 KORRIK - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë për keqpërdorim të pozitës kundër ministrit në detyrë për Zhvillim Rajonal, Fikrim Damka, dhe ushtruesit të detyrës së sekretarit të kësaj Ministrie, Besim Kamberaj. Prokurorët i akuzojnë Damkën dhe Kamberajn se i kanë shkaktuar buxhetit të Kosovës dëme në vlerë prej rreth 1 milion eurove. Sipas një njoftimi të Prokurorisë, Damka dhe Kamberaj akuzohen se i kanë tejkaluar kompetencat e tyre ligjore me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për dy organizata joqeveritare, Germin dhe Caritas Zviceran, gjatë periudhës mes 16 gushtit 2021 dhe 24 marsit 2022. Prokurorët i ngarkojnë ata se

kanë vepruar në kundërshtim me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe në kundërshtim me kompetencat e Ministrisë, kur kanë tejkaluar limitet e mundësisë së financimit të OJQ-ve nga fondet publike, “duke i financuar organizatat e përmendura pa organizuar thirrje publike”. “Ekziston dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit i kanë shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës në vlerë prej 1,040,000 euro”, thuhet në njoftim. Prokuroria tha se i ka Gjykatës Themelore në Prishtinë që, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, të pandehurit të shpallen fajtorë dhe ndaj tyre të shqiptohet dënim me gjobë dhe

dënim me burgim efektiv. Nëse shpallen fajtorë, ata rrezikojnë të dënohen deri në pesë vjet burgim, sipas kodit penal të Kosovës. Fikrim Damka, i cili është kryetar i Partisë Demokratike Turke të Kosovës - u emërua ministër i për Zhvillim Rajonal në Qeverinë Kurti II në vitin 2021. Damka ka thënë se nuk ka marrë ende asnjë ftesë nga gjykata pas ngritjes së aktakuzës për keqpërdorim të pozitës zyrtare. “Së pari, unë si ministër i Zhvillimit Rajonal në detyrë, nuk e kam marrë asnjë ftesë prej asnjë gjykate në Kosovë, ashtu që nuk mundem për ta komunikuar pasi nuk e kemi lexuar aktakuzën”, ka thënë Damka për mediet.



PËRKUJTOHET BETEJA E LOXHËS

PRISHTINË, 6 KORRIK - Presidentja Vjosa Osmani ka kujtuar betejën e Loxhës në 27-vjetorin e saj. Në një postim në “Facebook”, presidenca bëri të ditur se Osmani kujton njëherë nga përballjet më të lavdishme të luftës për liri. “Përballë një armiku të pamëshirshëm, luftëtarët e UÇK-së dëshmuuan se vullneti për liri është më i fortë se çdo makineri lufte. Loxha ishte më shumë se fushëbetejë, simbol i rezistencës dhe bashkimit për të mos u kthyer kurrë në robëri. Prej andej, thirrja për liri u përhap në gjithë Kosovën. Sot, si shtet i lirë e demokratik, kemi për detyrë ta ruajmë kujtesën për të rënë dhe t'i mbrojmë vlerat për të cilat u flijuan. Liria është amaneti i tyre! I përulemi me nderim dëshmorëve të Betejës së Loxhës dhe të gjithë dëshmorëve të UÇK-së”, ka



thënë Osmani.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se më 6 korrik 1998, në Loxhë të Pejës, u zhvillua njëra ndër betejat më të ashpra kundër forcave

armike. “Ishte një ndër përballjet më të fuqishme të luftës sonë, ku djemtë e Loxhës dhe të fshatrave përreth, deri në vetëflijim, mbrojtën tokën dhe nderin e këtij vendi. Duke

kujtuar sot përpjekjet e paepura të luftëtarëve dhe vullnetin e madh për çlirim, nderojmë kontributin e Loxhës në kohën më të lavdishme të historisë sonë të re, ndërsa

përulemi me nderim para dëshmorëve që u përjetësuan në themelet e lirisë: Tahir Shala, Rrustem Bruqi, Enver Alaj, Lumni Surdulli e Xhavit Qufaj. Po ashtu, kujtojmë luftëtarët nga fshati Rudicë, Nimon Bajraktari, Haki Ahmetxhekaj e Bashkim Mehmetaj, që ranë në rrugën e tyre për të sjellë armët e lirisë. Në të njëjtën ditë ra edhe bashkëluftëtari Arsen Mazrekaj. Nderim i përjetshëm për të gjithë luftëtarët e lirisë!”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se gjaku i derdhur në Loxhë është amanet në rrugëtimin tonë të përditshëm, të mbajmë gjallë kujtesën e së kaluarës dhe të ndërtojmë me dinjitet të ardhmen, të punojmë fort për forcimin e idealit të të rënëve për liri.

VALA E TË NXEHTIT AFRIKAN LARGOHET NGA KOSOVA, NGA E MËRKURA RESHJE DHE ULJE E TEMPERATURAVE

PRISHTINË, 6 KORRIK - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka njoftuar se vala e të nxehtit afrikan vazhdon të mbetet prezent mbi vendin tonë edhe gjatë dy ditëve të para të kësaj jave, mirëpo nga dita e mërkurë, kalimi i një fronti të freskët pritet të sjellë një rënie të dukshme të temperaturave maksimale. Ky fenomen do të ndikojë në kushte më të freskëta dhe një ulje të ndjeshme të temperaturave gjatë ditës. Nga dita e mërkurë, parashikohen reshje shiu, të cilat mund të shoqërohen me stuhi dhe shkarkime rrufesh. Erërat do të jenë të lehta, me dreksion kryesisht nga verilindja dhe veriperëndimi, ndërsa lokale mund të shfaqen erëra të forta në formë stuhish. Kjo periudhë do të shoqërohet

me një ndjeshmëri të ndryshuar të motit, që do të ndikohet nga faktorë atmosferikë të ndryshëm si kalimi i fronteve dhe aktiviteti elektrik në atmosferë. “E hënë. Mot me diell dhe vranësira të pakta. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 12-18 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 32-37 gradë celsius. Do të fryjë erë nga drejtimi i verilindjes me shpejtësi 1-5m/s. E martë. Mot me diell dhe vranësira të shpërndara. Vranësirat vende-vende mund të sjellin riga shiu, kryesisht në disa zona të kufizuara. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 12-18 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 32-37 gradë celsius. Do të fryjë

erë nga verilindja me shpejtësi 1-9m/s. E mërkurë. Mot me diell dhe vranësira të shpërndara. Vranësirat gjatë ditës do të intensifikohen duke bërë që në fusha barike të kemi ndryshime të mëdha. Kjo situatë meteorologjike do të krijoj kushte që mbi vendin tonë të bie shi i përcjell me breshër dhe shkarkime rrufesh. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 11 deri 16 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 21-24 gradë celsius. Do të fryjë erë e lehtë dhe lokalisht e fortë në formë stuhie nga drejtimi i verilindjes dhe i veriperëndimit. E enjte. Mot me diell dhe pjesërisht i vranët. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 9 deri 13 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen



të lëvizin ndërmjet 20-23 gradë celsius. Do të fryjë erë nga drejtimi i verilindjes e lehtë deri mesatare. E premte. Të premten parashihet të mbajë mot kryesisht me diell. Vranësirat mund të paraqiten për rreth relievit malor. Temperaturat

minimale do të lëvizin ndërmjet 9-12 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 22-26 gradë celsius. Do të fryjë erë nga drejtimi i veriperëndimit me shpejtësi 1-5m/s”, ka njoftuar IHMK-ja.

KOSOVA RRIK 100 PËR QIND IMPORTIN NGA SERBIA

PRISHTINË, 6 KORRIK - Importi i madh ka vendosur Kosovën në një pozitë të pafavorshme ekonomike, me një deficit enorm të lartë tregtar. Ky bilanc negativ tregtar po vazhdon ta dëmtojë vendin, kur kihet parasysh niveli i ulët i eksporteve të Kosovës si pasojë e mungesës së subvencioneve dhe politikave jo të favorshme për prodhuesit vendor.

Importi ka shënuar rritje të theksuar gjatë pesëmuajorit të parë 2025, ndërsa është ul vlera e mallrave të eksporteve gjatë kësaj periudhe krahasuar me muajt e njëjtë të vitit të kaluar.

Përveç kësaj, mallrat e Serbisë janë rikthyer fuqishëm në tregun e Kosovës këtë vit, pas një uljeje në vitet e fundit. Kosova ka tejkaluar dyfishimin e importit të produkteve me origjinë serbe në pesëmuajorin e parë të këtij viti krahasuar me periudhën përkatëse të vitit 2025.

Sipas të dhënave zyrtare të Doganës së Kosovës, vendi ynë nga Serbia, vetëm për pesë muajt e parë të këtij viti ka importuar mallra në vlerë 91 milionë euro apo 49 milionë euro (116 për qind) më shumë se në kohën e njëjtë të vitit të kaluar që ishin 42 milionë euro.

Ndryshimi i masës së sigurisë nga kufizimi i plotë, në kontroll të shtuar ka përshpejtuar rrjedhën e mallrave serbe në Kosovë.

Ndërkaq, marrëdhëniet tregtare mes Kosovës dhe Gjermanisë janë duke u thelluar gjithnjë e më shumë nga viti në vit.

Gjermania, sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, është partneri i parë i Kosovës sa u përket importeve në kohën janar-maj, e cila këtë vit ka lënë Turqinë në vendin e dytë me një diferencë të vogël.

Dogana e Kosovës në një përgjigje për “KosovaPress”, bënë të ditur se 12.7 milionë euro ka rënë vlera e eksportit të mallrave të Kosovës gjatë pesë muajve të parë të këtij viti,



krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërkaq, vlera e importit është rritur afro 380 milionë euro nga janari deri në maj të vitit 2025, krahasuar me periudhën përkatëse të vitit 2024.

Referuar të dhënave të Doganës së Kosovës, në muajt janar-maj 2025, vlera e eksportit nga Kosova është mbi 356 milionë euro, derisa në këtë periudhë të vitit të kaluar ishte rreth 369 milionë euro. Derisa diferenca në këto shifra kalon shifrën prej 12 milionë euro.

Në anën tjetër, vlera e importit në pesëmuajorin e parë të këtij viti është mbi 2 miliardë e 760 milionë euro, derisa në janar-maj 2024, kjo shifër ishte mbi 2 miliardë e 380 milionë euro.

Arsyet e rënies së eksportit dhe rritjes së importit vlerësohen ndryshe nga ekonomistët.

Njëra palë thekson ndikimin e politikës dhe mungesën e bashkëpunimit me sektorin privat, ndërsa pala tjetër i atribuon këto zhvillime

dobësive strukturore në ekonomi, përfshirë bazën e dobët prodhuese, mungesën e inovacionit dhe boshllëqet në tregun e punës.

Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu potencon se arsyet kryesore që rënies së eksportit dhe rritjes së importit lidhen ngushtë me ndërhyrjen e politikës në ekonomi dhe mungesën e bashkëpunimit me sektorin privat.

Ai vlerëson se agenda politike në Kosovë po e ngulfat zhvillimin ekonomik, ndërsa mungesa e dialogut dhe partneritetit publiko-privat po e dobëson seriozisht sektorin prodhues.

Në anën tjetër, drejtori Programor në Institutin Riinvest, Visar Vokri thotë se rënia e eksporteve dhe niveli i lartë i deficitit tregtar në Kosovë lidhen kryesisht me sfida të thella strukturore në ekonominë e vendit.

Ai thekson se një nga arsyet

kryesore është baza e dobët prodhuese, e cila sipas tij kufizon kapacitetin e Kosovës për të eksportuar në mënyrë konkurruese.

Prodhuesit në Kosovë, vazhdimisht iu kanë bërë thirrje institucioneve të vendit që të krijojnë politika të favorshme fiskale për të rritur eksportin.

Krahas rritjes enorme të importit, deficitit tregtar gjatë muajve janar-maj 2025 është thelluar në 2.4 miliardë euro.

Krahas kësaj, top tri shtetet e para që Kosova pranoi importe në muajt janar-maj të vitit 2025 janë Gjermania me rreth 384 milionë euro, Turqia me 381 milionë euro, pasuar nga Kina me mbi 329 milionë euro. Pas këtyre, tri shtetet e tjera që sjellin mallra në Kosovë janë Shqipëria, Italia dhe Maqedonia e Veriut.

Sipas statistikave të Doganës së Kosovës dërguar për “KosovaPress”, gjashtë shtetet e para të cilat pranuan eksport nga vendi ynë gjatë këtyre muajve janë Maqedonia e Veriut

me mbi 54 milionë euro, pastaj Shqipëria me mbi 52 milionë euro, pasuar nga Gjermania e Zvicra. Ndërkaq, në vendin e pestë është Mali i Zi, e cila në pesëmuajorin e këtij viti pranoi mallra nga Kosova në vlerë prej afro 21 milionë euro.

Në vitin 2024, Kosova shënoi një rekord historik për import të vlerës së mallrave.

Gjatë vitit të kaluar, Kosova ka eksportuar mallra në vlerë vetëm 889 milionë euro, ndërsa, për herë të parë ka importuar 6.38 miliardë euro brenda një viti.

Në vitin 2023 vlera e eksporteve ka qenë 819 milionë euro, importi po ashtu 5 miliardë 878 milionë euro.

Në vitin 2022 eksportet kanë qenë 920 milionë euro, importet 5 miliardë e 639 milionë euro, më 2021 ishin 755 milionë eksporte, kurse importet 4 miliardë e 684 milionë euro.

Më 2020, vlera e eksporteve ishte 474 milionë euro, ndërsa 3 miliardë e 296 milionë importe.

ZRRE MBRON VENDIMIN PËR TREGUN E LIRË ENERGJETIK, BIZNESET E KUNDËRSHTOJNË

PRISHTINË, 6 KORRIK - Oda Ekonomike dhe Aleanca Kosovare e Bizneseve e kanë kritikuar Rregullatorin e Energjisë për tregun e lirë të energjisë, duke thënë se vendimi ka dëmtuar rëndë bizneset. ZRrE, ndërkaq, ka njoftuar se do të ndjekë rrugën ligjore për të mbrojtur zbatimin e reformave në sektorin e energjisë.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka paralajmëruar se do të apelojë në instancat më të larta gjyqësore pas vendimit të Gjykatës Komerciale, e cila ka

pezulluar përkohësisht vendimin për dalje në tregun e hapur të energjisë për një rast të veçantë.

Për këtë ka reaguar kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, i cili për “Radio Kosovën” e ka quajtur këtë qasje të ZRrE-së “joprofesionale dhe kokëfortë”, duke theksuar se pezullimi i pjesshëm ka krijuar konkurrencë të padrejtë në treg. “Në momentin që një gjykatë pezullon vendimin për një biznes, ZRRE është dashur të aplikojë pezullimin për të



gjitha bizneset. Përndryshe, po dëmtohet konkurrenca e lirë dhe po cenohen bizneset vendore,” ka thënë ai. Sipas tij, vendimi për kalimin e bizneseve në tregun e lirë të energjisë ka shkaktuar pasoja serioze.

E kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, i tha “Radio Kosovës” se bizneset po vazhdojnë të ankohen për vendimin për dalje në tregun e lirë të energjisë në formë të detyrueshme, kurse ZRrE po i konteston vendimet e Gjykatës Komerciale.

“DOKTRINA E TË PAPRITURËS”, SI E KA NDRYSHUAR TRUMP LOJËN GLOBALE TË SIGURISË



Presidenti amerikan, Donald Trump, njihet për një gjë të vetme e të sigurt: është i paparashikueshëm! Në një intervistë muajin e kaluar, kur u pyet nëse do të bashkohej me Izraelin në një sulm ndaj Iranit, ai u përgjigj: “Mund ta bëj, mund të mos ta bëj. Askush nuk e di se çfarë do të bëj.”

Tipi i tij, ka sjellë një doktrinë të re në politikën e jashtme amerikane.

Politikë e varur nga karakteri i Trump

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare në London School of Economics, Peter Trubowitz, thekson se Trump ka krijuar një sistem vendimmarrjeje jashtëzakonisht të centralizuar, ndoshta më të centralizuarin që nga koha e Richard Nixon. Kjo bën që çdo

vendim të varet shumë nga karakteri, preferencat dhe temperament i tij personal. Kjo paparashikueshmëri nuk është gabim, por është kthyer në strategji dhe doktrinë politike, që përdoret për të maksimizuar ndikimin amerikan.

Teoria e “njeriut të çmendur”

Teoria politike e njohur si “Madman Theory” sugjeron që një lider i botës duhet të jetë kaq i paparashikueshëm dhe i aftë për çdo gjë, sa të frikësojë kundërshtarët dhe të nxjerrë përfitime prej tyre. Trump ka përdorur këtë teori për të rritur ndikimin ndaj aleatëve dhe për të ndryshuar marrëdhëniet tradicionale, veçanërisht me Evropën dhe NATO-n. Ai ka sfiduar aleatët tradicionalë, duke kritikuar

dhe duke rritur pritshmëritë e tyre për shpenzime në mbrojtje, duke ngjallur dyshime mbi angazhimin amerikan ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare. Kjo ka çuar në një lloj riorganizimi strategjik ku vendet evropiane po kërkojnë më shumë pavarësi operacionale.

Përplasjet me Rusinë, Ukrainën dhe Iranin

Marrëdhëniet me Rusinë kanë qenë të tensionuara, me përpjekje të dështuara për t'i afruar Trump dhe Putin. Ndërkaq, me Ukrainën, Trump është përfshirë në debate të hapura, por gjithashtu ka arritur marrëveshje ekonomike që favorizojnë SHBA-të. Sulmi në objektet bërthamore të Iranit në mandatit e tij të dytë është konsideruar si një

nga veprimet më të paparashikueshme dhe kontroverse. Ekspertët paralajmërojnë se kjo mund të nxjerrë Iranin më pranë ndërtimit të armës bërthamore, duke rritur tensionet në rajon. Trump ka përdorur paparashikueshmërinë edhe në politikën e brendshme, duke krijuar një atmosferë të paqëndrueshme politike që pasqyrohet edhe në politikën e jashtme. Kjo ka shqetësuar shumë partnerë ndërkombëtarë, të cilët janë duke rishikuar marrëdhëniet me SHBA-të në pritje të një stabiliteti më të madh. Profesorët e politikës në universitete të ndryshme theksojnë se kjo doktrinë e paparashikueshmërisë, teksa ka sjellë fitore afatshkurtra, mund të dëmtojë besueshmërinë e SHBA-së në arenën ndërkombëtare në plan afatgjatë.

Evropa drejt pavarësisë ushtarake?

Pas ndryshimeve në qëndrimin amerikan, liderët evropianë, si kancelari gjerman Friedrich Merz, kanë deklaruar nevojën për një pavarësi më të madhe ushtarake të Evropës nga SHBA-ja. Kjo kërkon një përpjekje të madhe për ndërtimin e kapaciteteve të veta të mbrojtjes dhe inteligjencës, që aktualisht varen shumë nga SHBA-ja. Doktrina e Donald Trump ka ndryshuar mënyrën se si funksionon politika e jashtme amerikane dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Ndërkohë që kjo strategji i ka dhënë disa përfitime afatshkurtra, e ardhmja e saj mbetet e pasigurt, pasi aleatët kërkojnë stabilitet dhe kundërshtarët po bëhen më të fuqishëm.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Marrëdhënie
Servisim
Përcaktim



Kosova U18 pëson humbje të thellë nga Islanda

